

KUJDES! MOS DËMTO BARKODIN

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS  
AGJENCIA QENDRORE E VLERËSIMIT TË ARRITJEVE TË NXËNËSVE

## PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2008

### SESIONI I

(I DETYRUAR)

VARIANTI A

E hënë, 9 qershor 2008

Ora 10.00

Lënda: Gjuhë shqipe dhe Letërsi  
Shkolla e mesme pedagogjike

#### Udhëzime për nxënësin

Testi është i ndarë në dy pjesë: në gjuhë shqipe dhe në letërsi.

Testi në total ka **25 pyetje**.

Në të dy pjesët ka kërkesa me **zgjedhje** dhe me **zhvillim**. Në kërkesat me zgjedhje rretho **vetëm** shkronjën përbri përgjigjes së saktë, ndërsa për kërkesat me zhvillim është dhënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.

Koha për zhvillimin e kërkesave të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Pikët për secilën kërkesë janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7	8a	8b	8c	9a	9b	10a
Pikët													
Kërkesa	10b	10c	11a	11b	12a	12b	12c	13	14	15	16	17	18
Pikët													
Kërkesa	19a	19b	20	21a	21b	22	23	24	25a	25b	25c	25d	
Pikët													

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

**PJESA I****GJUHË SHQIPE**

Ndërtimi i kështjellës së Rozafatit ka një gojëdhënë të bukur dhe të hidhur që na ka ardhur nga lashtësia jonë. Ja se ç' thotë kjo gojëdhënë.

...I ra mjegulla Bunës dhe e mbuloi të tërën. Kjo mjegull mbeti aty tri ditë e tri net. Pas tri ditësh e tri netësh fryu një erë e hollë dhe e lartoi mjegullën. E lartoi dhe e shpuri gjer në kodrën e Valdanuzit. Aty, majë kodrës, punonin tre vëllezër. Ndërtonin një kështjellë. Muri që e bënin ditën. u prishej natën dhe kështu nuk e lartnin dot.

Na shkon aty një plak i mirë.

- Puna mbarë, o tre vëllezër!
- Të mbarë paç, o plak i mirë! Po ku e sheh ti të mbarën tonë? Ditën punojmë, natën shembet. A di të na thuash ndonjë fjalë të mirë; ç'të bëjmë që të mbajmë muret në këmbë?....
- Në doni ta qëndroni, lidhuni me besabesë: vashave mos u rrëfeni, në shtëpi mos kuvendonit për fjalët që do t'ju them unë. Atë nga të tria kunatat që do të vijë nesër t'ju sjellë bukën, ta merrni e ta muroni të gjallë në mur të kështjellës. Atëherë kenit për të parë se muri do të zërë vend e do të qëndrojë për jetë e mot...

(Fragment nga legjenda “Rozafati” marrë nga libri i Mitrush Kutelit  
“Tregime të moçme shqiptare”)

Për pyetjet 1-7 rretho **vetëm** shkronjën që i përgjigjet alternativës së saktë.

1. Gjej fjalën e urtë. **1 pikë**
- A) Nuk i zënë këmbët dhe.  
B) Gjithë ditën na rrinë njerëz nëpër këmbë.  
C) Kush s'ka kokë, ka këmbë.  
D) S'i mbajnë dot muret në këmbë.
2. Në fjalinë: “A di të na thuash ndonjë fjalë të mirë”, fjala ndonjë është: **1 pikë**
- A) përemër i pacaktuar  
B) ndajfolje  
C) parafjalë  
D) përemër dëftor
3. Gjej trajtën e shkurtër të bashkuar në fjalinë: “Atë nga të tria kunatat që do të vijë nesër t'ju sjellë bukën, ta merrni e ta muroni të gjallë në mur të kështjellës”. **1 pikë**
- A) atë  
B) e  
C) ta  
D) të

4. Fjala e nënvizuar në fjalinë: “*Po ku e sheh ti të mbarën tonë?*” është: **1 pikë**
- A) përemër pyetës  
B) përemër pronor  
C) përemër vetor  
D) përemër dëftor
5. Gjej rrethanorin e vendit në fjalinë: “*Kjo mjegull mbeti aty tri ditë e tri net*”. **1 pikë**
- A) kjo mjegull  
B) aty  
C) tri ditë e tri net  
D) mbeti
6. Fjalja: “*Atë nga të tria kunatat që do të vijë nesër, ta muron të gjallë në mur të kështjellës*” është: **1 pikë**
- A) fjali e përbërë fthilluese  
B) fjali e përbërë përcaktore  
C) fjali e përbërë me tri pjesë  
D) fjali e përbërë kohore
7. Gjej fjalën e shkruar gabim. **1 pikë**
- A) përpjesëtim  
B) zëëmbël  
C) dimëror  
D) i shumëanshëm
8. Përcakto klasat e fjalëve të nënvizuara në fjalinë:  
“*Po ku e sheh ti të mbarën tonë?*” **3 pikë**
- a) ku: \_\_\_\_\_
- b) të mbarën: \_\_\_\_\_
- c) ti: \_\_\_\_\_
9. Ç’funktion kryen gjymtyra e nënvizuar në fjalinë: “*A di të na thuash ndonjë fjalë të mirë?*” Me se është shprehur ajo? **2 pikë**
- a) funksioni: \_\_\_\_\_
- b) shprehur me: \_\_\_\_\_

10. Gjej mbiemrin në fjalinë e mëposhtme dhe trego në ç'funksion është përdorur ai. Formo me mbiemrin e gjetur një emër të prejardhur.

*“Atë nga të tria kunatat që do të vijë nesër t’ju sjellë bukën, ta merrni e ta muroni të gjallë në mur të kështjellës.”*

3 pikë

a) mbiemri: \_\_\_\_\_

b) funksioni: \_\_\_\_\_

c) emri i prejardhur: \_\_\_\_\_

11. Gjej kryefjalën në fjalinë: *“Ndërtimi i kështjellës së Rozafatit ka një gojëdhënë të bukur dhe të hidhur...”*. Trego me se është shprehur.

2 pikë

a) kryefjala: \_\_\_\_\_

b) shprehur me: \_\_\_\_\_

12. Formo një fjali të përbërë me dy fjalitë e mëposhtme. Trego llojin e fjalisë që krijove dhe mjetin lidhës.

3 pikë

*Aty, majë kodrës, punonin tre vëllezër.  
Ndërtonin një kështjellë.*

a) fjalia: \_\_\_\_\_

b) lloji: \_\_\_\_\_

c) mjeti lidhës: \_\_\_\_\_

**PJESA II****Ismail Kadare****Kush e solli Doruntinë**

(Fragment)

Duke ecur me kujdes për të mos bërë zhurmë, Stresi iu afrua krevatit ku ishte shtrirë plaka. Koka e saj ishte mbështjellë me një kapuç të bardhë.

-Zonjë,- i foli me zë të ulët,- Zonja Mëmë,- (kështu e thërrisnin zakonisht qysh nga vdekja e djemve).- Jam Stresi, më njihni?

Ajo hapi sytë. Ata dukeshin të ftohtë nga tmerri e nga zia. Një copë herë ai e duroi vështrimin e saj, pastaj, duke afuar kokën edhe më te nënkrejsa e bardhë, pëshpëriti:

-Si jeni, Zonja Mëmë?

Shenja që bëri ajo me sy ishte e pakuptueshme.

-Doruntina ka ardhur mbrëmë?- pyeti Stresi.

E shtrira bëri “po” me sy. Pastaj sytë e saj vazhduan ta vështronin drejt Stresin, sikur kërkonin diçka prej tij. Stresi qëndroi ca çaste në mëdyshje.

-Po si ndodhi?- pyeti ai fare ultazi.- Kush e solli?

Plaka mbuloi sytë me njërën dorë dhe nga një lëvizje e kokës u kuptua se humbi ndjenjat. Stresi i kapi dorën dhe me vështirësi i gjeti pulsën. Ai punonte.

-Thirrë njërën nga gratë,- i tha Stresi me zë fare të ulët ndihmësit. Tjetri doli dhe u kthye pas pak bashkë me një grua. Stresi e la dorën e plakës dhe me po ata hapa të kujdesshëm iu afrua krevatit ku ishte shtrirë Doruntina. Tani i dalloi flokët e saj të verdhë mbi nënkrejsë. Në zemër ndjeu një sëmbim, por ai rrinte disi mënjane, i papërzier me ngjarjen që posa kishte ndodhur. Ishte një sëmbim i vjetër, që kishte lidhje me dasmën e saj, tre vjet më parë, atëherë kur ai, Stresi, në çastin që ajo po largohej hipur mbi kalin e bardhë të nusërisë, midis karvanit të krushqve, kishte ndier një pikëllim të tillë në zemër, saqë gati kishte pyetur veten me zë: po ç’kam kështu? Ishin të gjithë disi të pikëlluar dhe jo vetëm nëna e vëllezërit, por krejt gjindja, sepse ajo ishte e para vajzë që martohej kaq larg, mirëpo pikëllimi i Stresit ishte i një natyre të veçantë. Dhe në ato çaste që ajo po ikte, ai befasi e kishte kuptuar se ajo ndjenjë e ëmbël, që e kishte pushtuar kohët e fundit për të, s’kishte qenë veçse dashuri. Por ajo kishte qenë një dashuri tjetër lloj, e holluar si mjegulla mbi një hapësirë të pamatë, e padëndësuar asnjëherë, e frenuar prej tij qetësisht. Ishte si vesa e mëngjesit, kishte rënë vetëm minutat e para të zgjimit dhe pastaj, në orët e tjera të ditës dhe të natës qe tërhequr përgjithmonë. Dhe i vetmi çast kur ajo mjegull kaltëroshë qe përpjekur të dendësohej e të krijonte një re, ishte çasti i ikjes së saj. Por ai kishte qenë çasti i shkurtër, që ishte harruar shpejt.

Në këmbë para shtratit të saj, Stresi vështronte një copë herë fytyrën e Doruntinës. Ishte po aq e bukur si atëherë, në mos më tepër, me atë vijën e buzëve që ia bënte ato të rënda dhe të lehta njëkohësisht.

-Doruntinë,- i foli ai me zë fare të ulët,- ti ke mbërritur mbrëmë pas mesnate, apo jo?

Ajo bëri një “po” me sy. Stresi deshi ta shtynte edhe pak pyetjen që e mundonte, por ajo i doli vetvetiu:

-Po kush të solli?

Sytë e saj mbetën të palëvizshëm nën vështrimin e tij.

-Kush të solli, Doruntinë?- përsëriti ai.

Ajo nuk ia hiqte sytë, me atë boshësi të pashpresë në mes.

-Ti i the nënës se të solli yt vëlla, Kostandini, apo jo?

Ajo bëri prapë “po” me sy. Stresi u përpoq të gjente shenjat e çmendurisë në sytë e saj, por ata, si edhe më parë, ishin të zbrazur nga gjithçka.

-Po ti ndërkaq besoj se e ke marrë vesh që yt vëlla ka tre vjet që s'është më,- tha Stresi me po atë zë të shuar. Lotët, para se t'i shihte te ajo, i ndjeu brenda vetes. Ishin ca lotë tjetërlluj, gjysmë të dukshëm, gjysmë të prekshëm. Nën atë lotëri fytyra e saj u bë edhe më e largët. Ç'më gjeti kështu, dukej sikur thoshin tani sytë e saj. Pse s'më besoni...

Stresi ktheu kokën ngadalë nga ndihmësi i tij dhe nga gruaja tjetër që po rrinin pranë shtratit të zonjës plakë dhe u bëri me shenjë të dilnin. Ai u përkul prapë mbi gruan e re dhe i lëmoi dorën.

-Po si erdhe Doruntinë? Si e bëre gjithë këtë udhë të gjatë?

Sytë e saj, të zmadhuar jashtë mase, diçka përpiquej t'i mbushte.

*Për pyetjet 13 - 18 rretho vetëm shkronjën që i përgjigjet alternativës së saktë.*

13. Kontrasti në këtë fragment krijohet midis:

1 pikë

- A) dëshirës së Doruntinës për të folur dhe pamundësisë fizike të saj.
- B) dy grave dhe ambientit ku ndodhen.
- C) gjendjes në të cilën ndodhet Doruntina dhe nëna e saj,
- D) atmosferës së nderë dhe ndjenjës së brishtë të Stresit.

14. Gjendja e rëndë e Doruntinës është shkaktuar nga:

1 pikë

- A) kujtimet e së shkuarës.
- B) lodhja nga rruga e gjatë.
- C) përballja me një të vërtetë të frikshme.
- D) takimi me banorët e fshatit.

15. Në paragrafin e fundit Stresi e largon ndihmësin, sepse:

1 pikë

- A) ky i fundit duhet të kryejë disa detyra të tjera.
- B) Doruntina nuk do që të flasë në prani të të tjerëve.
- C) nuk do që ndihmësi t'i shohë dobësinë që ndjen.
- D) ka frikë se mos ndihmësi zbulon pjesë të hetimeve.

16. Thelbi i këtij fragmenti jepet në fjalinë:

1 pikë

- A) Në zemër ndjeu një sëmbim...
- B) Kush të solli, Doruntinë?
- C) Ti ke mbërritur mbrëmë pas mesnate.
- D) Sytë e saj, të zmadhuar jashtë mase, diçka përpiquej t'i mbushte.

17. Është neologjizëm i Kadaresë fjala:

1 pikë

- A) gjindja.
- B) kaltëroshe.
- C) lotëri.
- D) sëmbim.

18. Si shfaqet bota intime e Stresit në këtë fragment?

1 pikë

- A) E ftohtë dhe e ashpër.
- B) E qetë dhe e kujdesshme.
- C) E bukur dhe e vërtetë.
- D) E ngurtë dhe serioze.

19. Gjej në fragmentin e dhënë më sipër dy elemente që Kadareja i ka marrë nga **legjenda e lashtë** si dhe dy elemente që i ka **krijuar** ai vetë.

4 pikë

a) \_\_\_\_\_

b) \_\_\_\_\_

20. Gjatë gjithë këtij fragmenti autori thekson **sytë** e të dy grave. Çfarë komunikon secila përmes tyre?

2 pikë

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

21. Shkruaj dy tipare të stilit të Kadaresë që spikasin në këtë fragment.

2 pikë

a) \_\_\_\_\_

b) \_\_\_\_\_

22. Si është dhënë portreti i Doruntinës? Ç'raport krijon ai me atmosferën e përgjithshme?

2 pikë

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

23. Në fund të fragmentit Stresi përlohet, por jo Doruntina. Pse u ndodh kjo?

2 pikë

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

24. Dashuria e Stresit është e një lloji të veçantë. Shpjego si ndikojnë figurat e stilistikës (të paktën dy) dhe detajet e përdorura në dhënien e kësaj veçantie.

4 pikë

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

